



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS“
HASAN PRISHTINA” UNIVER
SITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10000 Prishtinë, Republikë e Kosovës Tel: +381 38 244 183 E-mail: rektorati@uni-pr.edu www.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe veterinarisë

Departamenti: Lavërtari Perimtari

Programi: Shkenca Bimore

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 ekësaj rregulloreje, ju njoftojmë:

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja **Shkendija Totaj**, me titull: “Ndikimi i polietilen glikolit (peg 6000) në stres të fara e fasules (*Phaseolus vulgaris* L.)

Punimi ndodhet në diskutim publik.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisionin e përbërje:

1. Prof. Dr. Imer Rusinovci kryetar
2. Prof. Dr. Sali Aliu-Mentorr,
3. Prof. Dr. Skënder Kaçiu anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund të kërkonin të udhëheqësi shkencor i temës Prof. Dr. Sali Aliu përmes e-mail adresës: Sali.aliu@uni-pr.edu

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurimi punës tonë!

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
STUDIMET MASTER
Departamenti “Shkenca Bimore”**



**NDIKIMI I POLIETILEN GLIKOLIT (PEG 6000) NË STRES TE
FARA E FASULES (*PHASEOLUS VULGARIS* L.)
(PUNIM MASTERI -MASTER THESIS)**

Mentori:
Prof.Dr.Sali ALIU

Studentja:
Bsc.Shkendije TOTAJ

PRISHTINË, 2024

Permbledhja

Gjinia e fasules (*Phaseolus sp.* L), përfshinë mbi 150 lloje, në Kosovë dhe në vendet e Ballkanit kultivohet lloji (*Phaseolus vulgaris*, L.) fasulja e bardhë. Fasulja e zakonshme, është bimë njëvjeçare që kryesisht kultivohet për kokrrat e saj, të cilat janë të pasura me materie ushqyese e në veçanti me përmbajtje të lartë të makro dhe mikroelementeve e sidomos me proteinave. Polietileni glikoli (PEG) është një polimer i gjithanshëm, me veti të shumta që e bëjnë të përdorshëm. Ai përdoret gjerësisht në industrinë ushqimore, në aplikime të ndryshme biomjekësore dhe farmaceutike, si dhe në produkte të përdorimit të përditshëm, si kozmetika po ashtu përdoret edhe në bujqësi për të shkaktuar stresin e thatësisë te bima. Qellimi I hulumtimit ishte te analizohet por edhe te identifikohet efekti dhe ndikimi I stresit ne bime I indukuar nga nje substance e quajtur PEG (Polietilen Glikol), Trajtime ishin me doza dhe tretamane te ndryshme te cilat jane te pershkruar ne detaje te meteriali dhe metoda e punes . Hulumtimi është realizuar në laboratorin e përmirësimit gjenetik të bimëve, departamenti Shkenca Bimore, Fakultetit i Bujqesise dhe Veterinarise Universiteti i Prishtinës – Prishtinë.Ky hulumtim është zhvilluar gjatë periudhës Qershor – Korrik 2024. PEG është përgatitur me dy përqendrime të ndryshme me 10% dhe 15%. Për përgatitje të tretësirës kemi përdorur ujin e distiluar.Dallimet per parametrat e hulumtuar si : **CO₂**– Koncentrimet e dioksidit të karbonit (CO₂) në hyrje dhe dalje. Tregon sa CO₂ përdoret nga bima.**H₂O**– Përqendrimi i avujve të ujit në hyrje dhe dalje, që përdoret për llogaritjen e shkallës së transpirimit, **Tleaf** – Temperatura e gjetheve në °C., **Tamb** – Temperatura e ambientit në °C, **RH** (Relative Humidity) – Lagështia relative e ambientit, **Flow** – Shkalla e rrjedhës së ajrit përmes sistemit të matjes, **VPD** (Vapor Pressure Deficit) – Diferenca e presionit të avullit, që tregon diferencën midis avullit të ujit në ambient dhe atij në stomata, e cila ndikon në shkallën e transpirimit., **WUE** (Water Use Efficiency) – Efikasiteti i përdorimit të ujit nga bima gjatë fotosintezës, **A** – Shkalla e fotosintezës neto në $\mu\text{mol m}^{-2} \text{s}^{-1}$, **Ci** (Internal CO₂ Concentration) – Koncentrimi i CO₂ brenda gjetheve, ishin me dallime larte sinjifiknate ne varesi prej nivelit te aplikimit te dozes se PEG 6000.

Fjale kyce: Fasulja, fotosinteza, PEG, tretmanet.
